

VENDIM
Nr.1427, datë 22.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 2 nëntor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-porti i Durrësit, në datën 3 nëntor 2008, të pesë autokolonave ushtarake italiane, të përbëra nga:

- Autokolona e parë, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e dytë, 20 (njëzet) automjete e 47 (dyzet e shtatë) trupa;
- Autokolona e tretë, 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete e 23 (njëzet e tre) trupa;
- Autokolona e katërt, 20 (njëzet) automjete e 32 (tridhjetë e dy) trupa;
- Autokolona e pestë, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa.

3. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 5 nëntor 2008, të tri autokolonave ushtarake italiane, të përbëra nga:

- Autokolona e parë, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa;
- Autokolona e dytë, 20 (njëzet) automjete e 35 (tridhjetë e pesë) trupa;
- Autokolona e tretë, 14 (katërmëdhjetë) automjete e 32 (tridhjetë e dy) trupa.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datat 2 e 3 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datën 5 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha